AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Nr. 1344 Prot.
Datë,më 11.04.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK KORÇË

Nr. 150 prot. Data 05.04.2022

Lënda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

Ofruesi publik i AFP-së: Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik, Korçë ju njofton krijimin e vendeve të lira për pozicionet:

a) Instruktor të kursit KUZHINË --------- 2 persona
b) Instruktor të kursit ARKIV --------- 1 person
c) Instruktor të kursit SERVIS XHENERIK NË AUTOMJETE TË LEHTA --------- 1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;

b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

-letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore:
- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm;
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës
20.04.2022.

DREJTOR
Anxhela TAHO